

**Kosova Demokratik Turk Partisi
(KDTP)**

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2016 - 31 Dhjetor 2016



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Shënimet e pasqyrave financiare.....	7-14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Kosova Demokrat Turk Partisi

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “KDTP”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2016, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-17.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2016, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet gjithëpërfshirëse për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 „Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Siç paraqitet në shënimin 5 të Pasqyrave financiare, Shpenzimet, Subjekti Politik ka pasqyruar Pagat dhe kompensimet ne vlerë 26,185 Euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016, në mungesë të dokumenteve mbështetëse, listës të punëtorëve për secilin muaj, deklarimeve tatimore, kontratave të punës, vendimet etj, ne nuk ishim në gjendje të konstatojmë saktësinë e shpenzimeve të prezantuar. Për më tepër SP nuk ka bërë deklarinimin dhe pagesën e tatimeve dhe kontributeve ne paga ashtu siç kërkohet me legjislacionin tatimor ne fuqi.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik në blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedurë të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.
- Gjatë auditimit tone në kemi vërejtur që të shpenzimet e reprezentacionit dhe karburantit , në disa raste SP nuk ka dokumentacion relevant mbështetës, përveç faturave, që do mundë të arsyetonin dhe mbështetnin shpenzimin e ndodhur.

Përgjegjësia e drejtuesve dhe e atyre të ngarkuar me udhëheqjen e SP për Pasqyrat Financiare

Drejtuesit e Subjektit politik janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon të likuideojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP-së.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit&Contosh.p.k

Haxhi Nimani
Auditor ligjor
05 Dhjetor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare Me 31 Dhjetor 2016

	Shën imi	Me 31 Dhjetor	
		2016	2015
		Shuma në Euro	Shuma në Euro
AKTIVA			
Pasuritë			
Pasuritë afatgjata			
Toka, objektet dhe pajisjet	2	20,050	22,033
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata :		20,050	22,033
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		-	-
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë		3,100	56
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Gjithsej pasuritë afatshkurtra :		3,100	56
Gjithsej pasuritë		23,150	22,089
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		(2,728)	516
Suficiti / (deficiti) i vitit		4,774	(3,244)
Gjithsej Ekuiteti		2,017	(2,728)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata:			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyra		20,050	22,033
Gjithsej detyrimet afatgjata:		20,050	22,033
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera		0	
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	3	1,084	2,784
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		1,084	2,784
Gjithsej detyrimet		21,134	24,817
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		23,150	22,089

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shën imi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2016	2015
		Në Euro	Në Euro
<u>Të hyrat</u>			
Të hyrat nga buxheti		63,000	63,000
Të hyrat nga anëtarësia		1,644	-
Donacionet dhe kontributet në të holla	4	2,656	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime			
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	2	3,083	3,083
Të hyrat tjera		56	389
Gjithsej të hyrat për vitin:		70,439	66,472
<u>Shpenzimet</u>			
Pagat dhe kompenzimet	5	26,185	23,140
Shpenzimet e transportit	5	4,423	6,488
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	5	10,807	12,958
Shpenzimet e fushatës	5		
Blerja e mallrave	5	1,100	
Shpenzimet e përgjithshme	5	21,260	26,007
Shpenzimet e ndryshme	5	2,019	1,123
Gjithsej shpenzimet për vitin		65,695	69,716
Suficiti (deficiti) për vitin :		4,744	(3,244)

1. Informata te përgjithshme

Partia u themelua ne vitin 1990 me emrin themeltar: Bashkësia Demokratike Turke. Ne vitin 2001 e ndërroi emrin ne Partia Demokratike Turke e Kosovës respektivisht në origjinale: Kosova Demokratik Turk Partesi

Partia Demokratike Turke e Kosovës i takon grupit te partive pluraliste, multi etnike, multi kulturore, udhëheq politikë për mes së cilës përpiqet të bënë promovimin dhe zhvillimin e vlerave demokratike e pluraliste në Republikës e Kosovës. Emri i shkurtër ose akronimi i Partisë Demokratike Turke të Kosovës është - KDTP Selia e KDTP-se është në Prizren.

Kryetar është MahirJagcilar

KDTP do të vazhdojë aktivitetin e sajë sipas rregullave të përcaktuara në Ligj, Rregullore dhe Program partiak.

Organizimi i partisë bëhet përmes organeve qendrore dhe degëve. Organet Qendrore të Partisë janë:

- Kuvendi i Partisë
- Presidenti
- Bordi Qendror i Drejtorëve
- Bordi i Presidentit
- Statuti dhe Komisioni i Auditimit
- Bordi qendror disiplinor

Pasqyrat financiare te KDTP-së janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën: NLB.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet Me 31 Dhjetor 2016

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Amortizimi i akumuluar	Amortizimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka	-	-	////////////////////	////////////////////	-
Objektet	-	-	-	-	-
Veturat	24,500	-	9,350	2,450	15,150
Pajisjet e zyrës	4,574	744	1,829	457	3,488
Pajisjet e teknologjisë informative	1,176	356	704	176	1,412
Pajisjet tjera	-	-	-	-	-
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet:	30,834	1100	8,800	3,083	20,050

Shënimi 3. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma ne Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma ne Euro
Paraja në bankë	3,100	56
Paraja në arkë		
Gjithsej Llogarite e arketueshme	3,100	56

Shënimi 4. Detyrimet tjera afatshkurta

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma ne Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma ne Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	-	-
Detyrimet për qira	-	-
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	-	--
Detyrimet afatshkurta	1,084	2,784
		-
Gjithsej Detyrimet tjera afatshkurta	1,084	2,784

Shënimi 5: Donacionet dhe kontributet ne e te holla
Viti qe përfundon me 31 Dhjetor 2016

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Erim Berisha			20.12.2016	30	30	
Ercan Spat			20.12.2016	64	64	
EROLL ZEKERIJA			01.12.2016	35	35	
Erim Berisha			19.11.2016	25	25	
Ercan Spat			11.11.2016	64	64	
MUFERA SRBICA SINIK			07.11.2016	300	300	
FIKRIM DAMKA			01.11.2016	60	60	
EROLL ZEKERIJA			01.11.2016	35	35	
KadirHuseyin			26.10.2016	300	300	
Erim Berisha			17.10.2016	30	30	
Ercan Spat			06.10.2016	64	64	
FIKRIM DAMKA			04.10.2016	60	60	
EROLL ZEKERIJA			03.10.2016	35	35	
ERGIN KALA			21.09.2016	135	135	
Erim Berisha			15.09.2016	30	30	
Ercan Spat			02.09.2016	128	128	
EROLL ZEKERIJA			01.09.2016	35	35	
Erim Berisha			13.08.2016	30	30	
FIKRIM DAMKA			02.08.2016	60	60	
EROLL ZEKERIJA			01.08.2016	35	35	
MAHIR YAGCILAR			22.07.2016	60	60	
Erim Berisha			16.07.2016	30	30	

Kosova Demokrat Turk Partisi

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

Ercan Spat			02.07.2016	64	64	
EROLL ZEKERIJA			01.07.2016	35	35	
FIKRIM DAMKA			01.07.2016	60	60	
MAHIR YAGCILAR			21.06.2016	60	60	
Erim Berisha			11.06.2016	30	30	
Ercan Spat			06.06.2016	64	64	
EROLL ZEKERIJA			01.06.2016	35	35	
FIKRIM DAMKA			01.06.2016	60	60	
MAHIR YAGCILAR			26.05.2016	60	60	
Erim Berisha			07.05.2016	30	30	
Ercan Spat			06.05.2016	64	64	
FIKRIM DAMKA			03.05.2016	60	60	
EROLL ZEKERIJA			01.05.2016	35	35	
MAHIR YAGCILAR			06.04.2016	60	60	
Erim Berisha			05.04.2016	30	30	
Ercan Spat			05.04.2016	64	64	
FIKRIM DAMKA			01.04.2016	60	60	
EROLL ZEKERIJA			01.04.2016	35	35	
EROLL ZEKERIJA			01.03.2016	35	35	
EROLL ZEKERIJA			01.02.2016	35	35	
EROLL ZEKERIJA			20.01.2016	35	35	
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				2,656	2,656	

Shënimi 6 . Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi ne Euro	Pagesa ne Euro	Borxhi I mbetur ne Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	25,227	25,227	-
Kontributi pensional nga punëmarrësi	-	-	-
Kontributi pensional nga punëdhënësi	-	-	-
Tatimi ne te ardhura personale	-	-	-
Benificionet te tjera	958	958	-
Gjithsej pagat dhe kompensimet	26,185	26,185	0
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike te huazuara	-	-	-
Karburantet	1,357	1,357	-
Biletat, aeroplanit/ autobusi, trenit, taxi etj.	2,418	2,818	(400)
Sigurimi dhe mire mbajtja e veturave	648	648	-
Çdo sigurim tjetër transporti	-	-	-
Gjithsej shpenzimet e transportit	4,423	4,823	(400)
Reklama, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	550	550	-
Ushqimi	5,932	5,932	-
Aktivitetet kulturore dhe rekreative	1,200	1,200	-
Radio dhe spotet televizive	-	-	-
Stenda e afishimi dhe reklamimet ne gazeta	-	-	-
Shpenzimet e tjera reklama, reprezentacioni dhe konferencat	3,125	3,125	-
Gjithsej reklama, reprezentacioni dhe konferencat	10,807	10,807	0
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	-	-	-
Gjithsej shpenzimet e fushatës	-	-	-
Blerja e mallrave			
Furnizime ne zyre	744	744	-
Pajisjet e vogla	356	356	-
Gjithsej blerja e mallrave	1,100	1,100	-
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit te zyrës	14,586	14,586	-
Telefoni, interneti dhe posta	1.124	1.339	(215)
Rryma, shërbimet komunale(uji dhe mbeturinat)	2,370	3,121	(751)
Shpenzimet e zhvlerësimit te pasuritë	3,083	////////////////////	////////////////////

Kosova Demokrat Turk Partisi

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

afatgjate			
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyre ne mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme:	21,160	19,043	(966)
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajta e pajisjeve dhe hapësira e zyrave	957	957	-
Shpenzimet qe nuk janë përfshi ne asnjë kategori tjetër	1,063	1,396	(334)
Gjithsej shpenzimet e ndryshme:	3,431	3,431	(334)
Gjithsej shpenzimet	65,695	64,312	(1,700)